



05/ Nr/ 6940 / 2024

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit shpallë:

## KONKURS PLOTËSUES

**Për Regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Shkollën e Mesme të Lartë “DARDANIA” për vitin shkollor 2024/25**

Emri i shkollës	Profili arsimor	Numri i nxënësve	Gjithsejtë
SHML “Dardania”	Shoqëror- Gjuhësor	20	20

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në shkollën e mesme të lartë për vitin shkollor 2024/25, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen/nostifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në shkollën e mesme të lartë duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron),
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9), dhe
- Certifikatën e lindjes.

### 3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2024/25, bëhet nga data **19,20 dhe 21 gusht 2024** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet, duke filluar nga ora **08:00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **22.08.2024**.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **23.08.2024**.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga kooha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

#### 4. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- |                                                          |               |
|----------------------------------------------------------|---------------|
| 1.Suksesi nga shkollimi i obliguar                       | (40%) 40pikë  |
| 2.Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20pikë  |
| 3.Numri i pikëve nga testi                               | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitoj (100%), 100 pikë.

**5. Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për shkollë të mesme të lartë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimumi 4.00** (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve)  
Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

5.1 Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl.6,7,8,9) mund t'i fitoj maksimalisht 40 pikë.

*Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:*

$$\text{suksesi}(\text{kl.6}+\text{kl.7}+\text{kl.8}+\text{kl.9})\times 2=40 \text{ pikë maksimumi.}$$

5.2.Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitoj 20 pikë.

*mesatarja e lëndës(I)+mesatarja e lëndës(II)+mesatarja e lëndës(III)+mesatarja e lëndës(IV)=20 pikë maksimumi.*

**Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve:**

5.3 **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore.**

- Lënda I- Gjuhë amtare
- Lënda II-Gjuhë angleze
- Lënda III-Histori
- Lënda IV-Gjeografi

Data 19.08.2024

Hani i Elezit

